



**Bordi i Zyrës së Rregullatorit të Energjisë,**

Duke u bazuar në:

- Nenin 8 paragrafi 1 nën paragrafin 1.6, Nenin 14 paragrafi 2 nën paragrafi 2.6 dhe 2.16, Nenet 25 dhe 43 të Ligjit mbi Rregullatorin e Energjisë nr. 03/L-185;
- Rregullën për vendosjen e Çmimeve të Gjenerimit (Rregulla për Çmimet e Gjenerimit) dhe,
- Aplikacionin e KEK-Gjenerimit të dorëzuar në kuadër të Shqyrtimit të Tetë të Tarifave të Energjisë Elektrike(SHTE8) me dokumentacionin relevant sqarues;

Pas shqyrtimit të shkresave dhe dokumenteve relevante, duke u bazuar në dispozitat ligjore të cekura më lartë, **në seancën e mbajtur më 16 maj 2014 nxori këtë:**

## V E N D I M

- I. APROVOHEN TË HYRAT E LEJUARA MAKSIMALE (MAR) që do të mbulohen nga operatori i licencuar i Termocentralit të Kosovës A dhe operatorit të licencuar të Termocentralit të Kosovës B (Gjeneratorët e Rregulluar) përmes ngarkesave për ofrimin e energjisë dhe kapacitetit për Furnizuesin Publik me energji elektrike për vitin relevant tarifor 2014 apo SHTE8, i cili fillon nga 1 prilli 2014.

## ARSYETIM

- ✚ Zyra e Rregullatorit të Energjisë (ZRRE) ka pranuar nga Korporata e Energjisë Elektrike e Kosovës SH.A. (KEK) aplikacionin e KEK-Gjenerimit, për aprovim të Hyrave të Lejuara Maksimale që duhet mbledhur nga Gjeneratorët e Rregulluar përmes ngarkesave për energji dhe kapacitet.
- ✚ Në marrjen e vendimit të tij që MAR të rimerret nga Gjeneratorët e Rregulluar, ZRRE ka marrë parasysh dokumentet si në vijim që janë lëshuar dhe publikuar në ueb faqen e saj:
  - Vlerësimi i përfundimtar – Vlerësim i detajuar i Gjenerimit të KEK-ut, i publikuar me datën 22 shkurt 2013;
  - Vlerësimi i përfundimtar-Pasqyrë, i publikuar me datën 22 shkurt 2013;
  - Raport Vlerësimin-Llogaritja e të Hyrave Maksimale të Lejuara dhe Ngarkesave të Gjenerimit të Rregulluar.



- II. Të Hyrat e Lejuara Maksimale që do të mbulohen nga Gjeneratorët e Rregulluar “TC Kosova A dhe B “për vitin relevant tarifor SHTE8 janë **139,535,183** euro.
- III. Të Hyrat e Lejuara Maksimale për Gjeneratorët Rregulluar do t’i nënshtrohen Procesit të Përshtatjeve të Rregullta vjetore, sipas Rregullës për vendosjen e çmimeve të gjenerimit.
- IV. Të Licencuarit për Gjeneratorët e Rregulluar duhet t’i përgatisin dhe dorëzojnë për aprovim ZRRE-së ngarkesat për kapacitet dhe energji për mbulimin e Të hyrave të Lejuara Maksimale të përcaktuara me këtë Vendim, brenda një afati sa më të shkurtë.
- V. Ngarkesat e propozuara nga të licencuarit duhet ndjekur parimet e vendosura në Rregullin për Çmimet e Gjenerimit dhe Metodologjia e Përcaktimit të Ngarkesave për Gjeneratorët e Rregulluar.
- VI. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe atë angleze. Në rast të ndonjë mospërputhjeje në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhës shqipe.
- VII. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së, dhe do të publikohet në ueb faqen zyrtare të ZRRE-së.

**Këshillë juridike:** Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

#### **Bordi i ZRRE**

---

Enver Halimi, Kryesues

---

Merita Kostari, Anëtar

---

Krenar Bujupi, Anëtar